



KËSHILLI PËR DEMOKRACI DHE TË DREJTA TË NJERIUT COUNCIL FOR DEMOCRACY AND HUMAN RIGHTS SAVET ZA DEMOKRATIJU I LJUDSKA PRAVA

Këshilli për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut, në takimin e mbajtur më 21 dhjetor 2023, nxorri rekomandimet konkrete mbi çështjet e mëposhtme:

a. Sundimi i ligjit

- Finalizimi sa më i shpejtë i kontratës për hallkat elektronike (monitoruesit elektronikë);
- Miratimi i Projekt Kodit Civil;
- Miratimi i Strategjisë kundër Korrupsionit;
- Zbatimi i Deklaratës së Përbashkët të Zotimeve të nënshkruar nga Ministria e Drejtësisë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Zyra e Prokurorit të Shtetit dhe Gjykata Supreme;
- Rishikimi i Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për politikat ndëshkimore, si dhe shtimi i kapaciteteve monitoruese për zbatimin e udhëzuesit, veçanërisht në rastet e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore;
- Vazhdimi i koordinimit ndër-institucional për zbatimin e tërësishëm të Strategjisë për Sundimin e Ligjit.

b. Parandalimi i dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore

- Të amendamentohet Ligji Nr. 05/L-022 për Armë, në mënyrë që:
 - të parashihet revokimi i përhershëm i lejes për posedimin e armëve për kryesit e veprave penale të dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me baza gjinore në rastet kur kryesit kanë qenë të pajisur me leje, dhe
 - t'u pamundësohet marrja e lejes në të ardhmen kryesve të këtyre veprave penale.
- Të amendamentohet Ligji Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore për të definuar më gjerësisht “dhunën ekonomike”;
- Të amendamentohet Kodi Penal i Republikës së Kosovës në mënyrë që femicidi të përfshihet si vepër e veçantë penale;
- Të trajtohet në grupe punuese çështja e dezinformimit mbi baza gjinore dhe të ofrohen rekomandime konkrete për adresimin e këtij problemi;
- Të trajtohet në grupe punuese dhuna në hapësirën digjitale ndaj grave dhe vajzave:
 - Të krijohet një departament i veçantë për dhunën në hapësirën digjitale në kuadër të Policisë së Kosovës;

- Të amendamentohet Kodi Penal i Republikës së Kosovës në mënyrë që dhuna në hapësirën digjitale të përfshihet si vepër e veçantë penale;
- Të iniciohet fushatë vetëdijësuese nën patronatin e Presidentes lidhur me dhunën mbi baza gjinore të facilituar nga teknologjia.
- Të fillojë puna për hapjen e qendrave referuese ashtu siç parashihet me nenin 25 të Konventës së Stambollit për:
 - dhunën seksuale ose krizën nga përdhunimi;
 - viktimat;
 - vizitat mjekësore dhe mjekoligjore, dhe
 - mbështetjen për traumat dhe këshillimin për viktimat.
- Të vazhdohet fushata gjithëpërfshirëse e aktivizmit kundër dhunës ndaj grave përgjatë tërë vitit të ardhshëm, në bashkëpunim me partnerët e “16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore”;
- Të mblidhen grupet punuese të Këshillit për dhënien e rekomandimeve specifike në adresimin e çështjeve në vijim:
 - Masat për adresimin e punës së papaguar të grave;
 - Masat për zbatimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor;
 - Masat për promovimin e barazisë gjinore brenda institucioneve;
- Të organizohen fushata vetëdijësuese/trajnime për përdorimin e gjuhës së ndjeshme gjinore dhe të dhënave të ndara sipas gjinisë brenda administratës publike;
- Të organizohen takime me bashkësitë e ndryshme fetare me qëllim të përfshirjes së tyre dhe bashkëpunimit drejt parandalimit të dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore;
- Të angazhohen psikologë në të gjitha fazat e procedurës penale, duke filluar nga faza e hetimit:
 - Përfshirja e psikologëve veçanërisht në rastet e dhunës seksuale ndaj të miturve;
 - Ndarja e mjeteve buxhetore për angazhimin e tyre.
- Të rritet përkrahja institucionale për viktimat e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore përmes përkrahjes së tyre financiare, që ka për qëllim pavarësimin e tyre financiar;
- Të iniciohen procedurat për harmonizim të ligjeve të veçanta të identifikuar nga Grupi Punues për Barazi Gjinore në kuadër të Këshillit, me Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore;
- Të mblidhen dhe përpunohen të dhënat e ndara në bazë të gjinisë me qëllim të politik-bërjes të bazuar në të dhëna;
- Të ideohen dhe iniciohen hulumtime që adresojnë aspektet psiko-sociale, kulturore dhe ekonomike të shoqërisë që ndikojnë në shpërfaqjen e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore.